



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 17.02.2025

Nr: 6

Ora: 11:30

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 01, DATË 14.02.2025
TË DEPOZITUAR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 17.02.2025, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

OBJEKT: 1. Ankim kundër pikës 2 të vendimit nr. 83, datë 11.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 1 regj., datë 14.02.2025.

Në mbledhjen e datës 17.02.2025, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr.1, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 01, datë 14.01.2025, të paraqitur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 19.02.2024, ora 12:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Elvis Çefa - Relator

Elvin Lako - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar